

"INTER TRADE & DISTRIBUTION" SH.P.K.

Regjistruar në QKR: dt. 24.03.2009.

NUIS: K91524002L.

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, Shqipëri.

EKSTRAKT I VENDIMIT
TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"INTER TRADE & DISTRIBUTION" SH.P.K.
Nr. 24, Datë 18.04.2024.

Sot, më datë 18.04.2024, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "INTER TRADE & DISTRIBUTION" sh.p.k., me adresë në: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, më datë 24.03.2009, me NUIS K91524002L, e përbërë nga zotëruesit e 100% të kuotave të kapitalit:

1. **Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Investment Joti – Infosoft Group"**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Znj. Blerta Elezaj, e cila zotëron 52% të kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Plarent Kristo**, i cili zotëron 24% të kapitalit të Shoqërisë.
3. **Z. Roland Joti**, i cili zotëron 24% të kapitalit të Shoqërisë.

Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve plotëson kuorumin e caktuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Asambleja ka për rend dite:

- Diskutim në lidhje me destinimin e fitimit të vitit financiar 2023 të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k.

Në përputhje me nenin 9.8 të Statutit të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k., i ndryshuar më dt. 06.12.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Referuar pasqyrave financiare vjetore për vitin financiar 2023, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 23, dt. 18.04.2024, rezulton fitimi në vlerën 556,261,600 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë.
2. Një pjesë e fitimit të Shoqërisë në vlerën 100,000,000 (njëqind milion) lekë është shpërndarë paraprakisht si dividend tek Ortakët e Shoqërisë, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 17, dt. 26.01.2024.
3. Pjesa e fitimit në vlerën 455,261,600 (katërqind e pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë do të shpërndahet tek Ortakët e Shoqërisë, në vlerat si vijon:
 - "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. – 250,836,032 (dyqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e dy) lekë;
 - Z. Plarent Kristo – 109,262,784 (njëqind e nëntë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë;
 - Z. Roland Joti - 95,162,784 (nëntëdhjetë e pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.



Për sa më sipër, plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 77 dhe 78 i Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe nga Statuti i Shoqërisë. Kjo konfirmohet nga Certifikata e Aftësisë Pagueuse, e lëshuar nga Administratori i Shoqërisë, nën përgjegjësinë e tij të plotë.

Në përputhje me Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 58 "Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim", neni 29 "Përjashtimi nga pjesëmarrja" dhe neni 59 "Norma e mbajtjes së tatimit në burim", Ortakut "Investment Joti – InfoSoft Group" sh.p.k. nuk do t'i llogaritet tatimi në burim mbi dividendin, kurse dy Ortakëve të tjerë, Z. Plarent Kristo dhe Z. Roland Joti, do t'u llogaritet tatimi mbi dividendin në masën 8%.

4. Pjesa e fitimit në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë do të destinohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k., në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas përqindjes respektive të pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, përkatësisht:

- "Investment Joti – InfoSoft Group" sh.p.k. – 520,000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë;
- Z. Plarent Kristo – 240,000 (dyqind e dyzet mijë) lekë;
- Z. Roland Joti – 240,000 (dyqind e dyzet mijë) lekë.

5. Në përfundim të procesit të zmadhimit të kapitalit, kapitali i regjistruar i shoqërisë "Inter Trade & Distribution" sh.p.k. do të bëhet 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota me vlerë nominale si më poshtë:

Nr.	Ortakët	Vlera e kapitalit para zmadhimit		Vlera e kapitalit pas zmadhimit	
		Vlera nominale (lekë)	Në %	Vlera nominale (lekë)	Në %
1.	"Investment Joti – InfoSoft Group" sh.p.k.	260,000	52%	780,000	52%
2.	Z. Plarent Kristo	120,000	24%	360,000	24%
3.	Z. Roland Joti	120,000	24%	360,000	24%
	Total	500,000	100%	1,500,000	100%

6. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore.

7. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, departamenti ligjor dhe departamenti i financës për ekzekutimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

"Investment Joti-InfoSoft Group" sh.p.k.

Blerta ELEZAJ



Plarent KRISTO



Roland JOTI

